

GJERMANI

HOMAZH PËR DËSHMORËT

Mjerisht, raportet politike midis Shqipërisë dhe Kosovës në këtë kohë, kur më së paku duhej të ishin në këtë gjendje, janë mjaft të fragmentarizuara dhe për këtë dikush duhet të japë përgjegjësi para kombit dhe para historisë

Ludwigshafen, tetor

Duë më parë duke filluar që nga ora 14, në shtesim e këtij qyteti (Berliner str. afër Arbeitsamt-it) ishin tubuar bashkatdhetarë të shumtë, të cilët dëshironin që të merrnin pjesë në këtë manifestim përkujtimor, për t'u bërë nderime të gjithë dëshmoreve të lirisë, të rënë në luftë për çlirimin e Kosovës. Ishte formuar kolonë e gjatë njerëzish, të cilët me qirinj të ndezur në dorë, pankarta dhe flamuj kombëtarë këtij manifestimi i jepnin pamje të dhembshme, por edhe kronare, sepse me këtë dëshirohej që kësaj here këtu t'i thuhet se bijtë e popullit shqiptar, kudo që gjenden, për asnjë çast nuk i harrojnë heronjtë dhe dëshmorët e vet të lirisë.

Këtë manifestim e udhëhoqi z. Nikollë Shabani, kryetar i bashkësisë shqiptare për këtë land, në të cilin, përpos bashkatdhetarëve tanë, mori pjesë edhe z. Bujar Muharremi, gazetar i njohur i RTVSH-së, i cili me këtë rast mbajti një fjalë rast, pastaj disa studentë recituan vargje poetike kush-tuar jetës dhe veprës së dëshmoreve të rënë në mbrojtje të Kosovës.

Pas përfundimit të homazhit, në lokalet e xhamisë, në këtë qytet, u mbajti një takim-tryeze me bashkatdhetarët tanë, të cilën e udhëhoqi z. Ramiz Kukleci, kryetar i BISHM. Në këtë takim-tryezë merrnin pjesë edhe imami i kesaj xhamie, pastaj z. Bujar Muharremi, Nikollë Shabani, Sinan Hiseni, Bjaran Osmani, Ilmi Ibishi etj.

Që në fillim... me një minutë heshtje, u bë nderim dëshmoreve të lirisë për të vazhduar më pastaj me diskutimet rreth situatës aktuale politike në Kosovë dhe në Shqipëri. Pas fjalës hyrëse, nga të pranishmit u shtruan shumë pyetje, të cilat me së shumti u drejtuan z. B. Muharremi, prania e të cilit zgjoi interesim mjaft të madh. Ndër pyetjet e shumta që u shtruan në këtë tryezë po veçojmë, pse takimi i Qeverisë së Kosovës me subjektet politike u mbajti në Turqi e jo në Shqipëri, a ka pasur UÇK-ja pengesa nga politika zyrtare në Shqipëri, sa e ndihmon-pengon Qeveria e B. Bukoshi UÇK-në, çfarë janë prononcimet e I. Rugovës rreth formimit të qeverisë

së pajtimit kombëtar, pastaj a i qëndruan me besnikëri institucionet shtetërore të Kosovës mandati të popullit, pse sistemi mazhoritar vazhdon të mbisundojë në Shqipëri dhe a janë këto sisteme vazhdimësi e sistemit të mëparshëm komunist, a jeni gazetar i sistemit të Ramiz Alisë, etj., etj.

Duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve, z. B. Muharremi, ndër të tjera, tha: - Ka ardhur koha që t'i lemë fjalët dhe t'i rrekemi punës, se gjermanët kanë punuar më se 50 vjet për bashkimin e dy Gjermanive, por kurrë nuk kanë folur hapur e me zhurmë të madhe, bashkimin dhe liria e një populli vjen vetë kur asaj i vihet gjaku në themele, ajo nuk

Qeveri-UÇK, ai tha se ato janë çështje të brendshme të tyre, por edhe mjaft neutralgjike, duhet kuptur se nuk ka pavarësi pa institucione shtetërore të Kosovës, se e ardhmja e kombit tonë është në duart tona. Mbase për pavarësinë e Kosovës duhet të bëjmë të gjithë me tepër seç kemi bërë deri më tani, duke i dhënë më shumë rëndësi bashkimit dhe unitetit kombëtar. Mjerisht, raportet politike midis Shqipërisë dhe Kosovës në këtë kohë, kur më së paku duhej të ishin në këtë gjendje, janë mjaft të fragmentarizuara dhe për këtë dikush duhet të japë përgjegjësi para kombit dhe para historisë.

Rreth qëndrimeve të politikës



Nga një protestë e shqiptarëve

vjen pa gjak dhe sakrificë, prandaj edhe nuk duhet të jemi të zhgënjyer në procesin e pavarësisë dhe të lirisë. Të rinjtë e Kosovës i dëshmuuan botës se e duan lirinë dhe kanë besim të jashtëzakonshëm në pavarësinë e saj, siç dëshmoi se kjo rini ishte pjellë e popullit shqiptar dhe se nuk ishte rini vetëm për "Disco klube", por rini që di edhe të luftojë kundër armikut dhe të vdesë për liri, sepse ishin të bindur se vetëm rruga e sakrificave është rruga e lirisë. UÇK-ja për gjashtë muaj nuk ka mundur të bëhet ushtri legjendare, por ka treguar se populli shqiptar kurrë nuk i nënshtrohet robërisë, se ajo është një forcë kombëtare dhe nuk mund të ketë kurrfarë dialogu eventual me agresorin pa pjesëmarrjen e saj dhe se, këto ditë, është duke u biseduar për nënshkrimin e një marrëveshjeje midis UÇK-së dhe OSBE-së.

Lidhur me raportet

evropiane ndaj çështjes shqiptare, në përgjithësi, dhe asaj të Kosovës, në veçanti, tha se Evropa ka shumë politika dhe fytyra, të cilat i ndërton sipas nevojës dhe interesave të saja në Ballkan, të cilat përplasen me njëra tjetrën, sidomos kur është fjala për çështjen e popullit shqiptar, prandaj atë që nuk e bëjnë ata, duhet ta bëjnë ne vetë.

Në fund, duke iu përgjigjur pyetjes së shtruar se a është gazetar i sistemit të R. Alisë, B. Muharremi shtoi se gjatë tërë punës së tij 20-vjeçare, si gazetar për politikë të jashtme, gjithmonë ka qenë në shërbim të kombit dhe jo në shërbim të partisë dhe se gjithnjë është angazhuar për kombëtarizimin e politikës shqiptare, sepse pa zhveshjen e saj nga petku partiak nuk mund të zhvillohet kurrfarë politike, e cila do t'u shërbejë vetëm interesave gjithëkombëtare.

Rexhep ELEZAJ